

**RREGULLORJA**  
e  
**“Funksionimit të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar”**

**Neni 1**  
**Objekti i rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave lidhur me organizimin dhe funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, ne vijim referuar “Komiteti”

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të pikes 7, të nenit 35, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit. Korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar

**Neni 3**  
**Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar**

Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar është ngritur me Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit. Korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar

Qëllimi kryesor i ngritjes së Komitetit është:

- Mbikqyrja e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.
- Marrja e vendimeve për destinacionin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara
- Administrimi i fondit të posacëm

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë së Komitetit**

Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar është ngritur me

1. Ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit. Korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar
2. Ligjit nr.34, dt 4.07.2019 ”Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar.
3. Ligjit nr. Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit.”

4. Aktit Normativ nr.1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurise publike” ( OFL),
5. Pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit.

#### **Neni 5**

#### **Përbërja e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar**

- 1- Komiteti është i përberë nga kryetari dhe tetë anëtarë. Kryetari është i propozuar nga Ministri përgjegjes per rendin dhe sigurine publike, ndërsa tetë anëtarët e tjerë janë të propozuar respektivisht nga:
  - Ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë
  - Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë
  - Ministri përgjegjës për çështjet sociale
  - Prokurori i Përgjithshëm,
  - Prokuroria e Posaçme Kundër korupsionit dhe Krimit të Organizuar
  - Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara,
  - Kryetari i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor,
  - Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- 2- Komiteti mbledhet pranë ministrise përgjegjese per rendin dhe sigurine publike dhe në veprimtaritë e komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike ose organizatave të tjera, vendase a të huaja, veprimtarë në fusha me interes për zbatimin e ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.
- 3- Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara ushtron funksionin e sekretariatit teknik pranë komitetit

#### **Neni 6**

#### **Detyrat dhe funksionet e Komitetit**

Komiteti per realizimin e qellimit te tij te percaktuar ne nenin 3 te kesaj rregulloreje ka këto detyra:

- 1) Mbikëqyr administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe vlereson performancën e administratoreve.
- 2) Merr vendime për destinacionin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

- 3) Bazuar në kërkesat e mbërritura në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe të përcjella prej agjencise për Komitetin, mer vendim për tjetërsimin apo shitjen e pasurive të sekuestruara që humbasin vlerën.
- 4) Bazuar në kërkesat e mbërritura në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe të përcjella prej agjencise për Komitetin, merr vendim për shitjen e pasurive të konfiskuara.
- 5) Bazuar në kërkesat e mbërritura në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe të përcjella prej agjencise për Komitetin, nga kërkesat të sjellura nga çdo institucion i përfaqësuar në Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, mer vendim për dhënien në përdorim të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, institucioneve shtetërore dhe pushtetit lokal.
- 6) Bazuar në prioritetet e përcaktuara në nenin 37 të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, ndryshuar me 70/2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për disponimin efektiv të të ardhurave brenda Buxhetit të Shtetit, pagimin e shpenzimeve operative të agjencisë dhe shpërndarjen e Fondit të Posaçëm.
- 7) Kerkon informacion çdo 6 muaj institucioneve qendrore dhe njësite vendore, që i kanë në përgjegjësi administrimi, pasuritë e paluajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara, me të dhëna të hollësishme për gjendjen dhe mënyrën e përdorimit të këtyre pasurive.
- 8) Në qoftë se Komiteti vëren se mënyra dhe kushtet e përdorimit të raportuara, nuk përputhen me vendimin e marre , mer masa ndaj këtyre institucioneve deri në ndryshimin e destinacionit të pasurive.
- 9) Shqyrton raportet periodike (3-mujore) të veprimtarisë të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në lidhje me pasuritë objekt i veprimtarisë së këtij Komiteti.
- 10) Nxit bashkëpunimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara me institucionet publike, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e pastrimit të parave.
- 11) Harton, miraton dhe zbaton një program të hollësishëm të veprimeve dhe të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve të fushës.
- 12) I propozon institucioneve të përfaqësuara me anetar në këtë Komitet të ndermarrin nisma propozuese për projektakte që përmirësojnë veprimtarinë e këtij Komiteti, qëllimin dhe objektin e tij.

- 13) Therret eksperte dhe specialiste per t  degjuar ne Komitet.
- 14) Fton t  marrin pjes  n  mbledhjet e komitetit p rfaq sues t  institucioneve publike ose organizatave t  tjera, vendase ose t  huaja, veprimtare n  fusha me interes ne funksion t  objektit t  pun s s  Komitetit Nderinstitucional p r Masat Kunder Krimin t  Organizuar.

#### **Neni 7**

#### **M nyrat e funksionimit t  Mbledhjeve t  Komitetit**

1. Komiteti K shillimor Nd rinstitucional i Ekspert ve p r Masat Kund r Krimin t  Organizuar mblidhet sa here te jete e nevojshme, me kerkese te kryetarit ose cdo anetari, por jo me pak se 1 (nje) here ne 3 (muaj).
2. Gjate ushtrimit te veprimtarise se tij Komiteti mbeshtetet nga Sekretariati Teknik, i cili kryen sherbime ndihmese teknike dhe administrative.
3. Mbledhjet e Komitetit zhvillohen ne mjediset e ministrise pergjegjese per rendin dhe sigurine publike ose online nepermjet platformave online te licensuara qeveritare.
4. Komiteti i zhvillon mbledhjet kur jan  t  pranish m shumica e an tar ve t  tij( jo m  pak se 5 antar ).
5. Vendimet merren me shumic n e votave t  an tar ve te pranishem ne mbledhje.
6. Per ceshtjet qe nuk jane te parashikuara ne kete rregullore, qe kane te bejne me menyren e organizimit te punes se Komitetit, per aq sa eshte e mundur, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8480 , date 27/05/1999, si dhe ligjit nr. 10192 date 3.12.2009, i ndryshuar.

#### **Neni 8**

#### **Kryetari**

Kryetari i Komitetit:

- P rfaq son Komitetin n  takimet e ndryshme t  nivelit t  lart  me institucionet publike apo me partneret nd rkomb tare.
- Miraton Vendin, Dat n dhe Or n e mbledhjes s  Komitetit.
- Miraton Rendin e dit s s  mbledhjes.
- Drejton mbledhjen e komitetit.
- Organizon k shillime paraprake me an tar t e komitetit.
- Ngarkon me detyra an tar t e Komitetit, n  kuad r t  zbatimit t  vendimeve.
- Pas propozimeve t  an tar ve, vendos thirrjen e ekspert ve dhe t  specialist ve p r t' u d gjuar n  komitet.
- Nd rmerr veprime t  tjera q  i gjykon t  nevojshme.
- Fton t  marrin pjes  ne mbledhjet e komitetit p rfaq sues t  institucioneve publike ose organizatave t  tjera, vendase a t  huaja, veprimtar  n  fusha me interes n  funksion t  objektit t  pun s s  Komitetit Nd rinstitucional p r Masat Kund r Krimin t  Organizuar,

- Miraton procesverbalin e mbledhjeve dhe vendimet e Komitetit

### **Neni 9**

#### **Anëtarët e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar**

Në mbledhjen e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, votat e anëtarëve janë të barabarta.

Çdo anëtar ka të drejtë të:

- a) Propozoje kryetarit perfshirjen apo heqjen e ceshtjeve ne rendin e dites per mbledhjet e komitetit, jo me vone se 1 (nje) dite perpara mbledhjeje.
- b) Propozojne thirrjen e eksperteve apo perfaqesuesve te institucioneve publike ose organizatave te tjera, vendase ose te huaja, per t'u degjuar ne mbledhjen e Komitetit.
- c) Ndjekin dhe raportojne zbatimin e detyrave qe marrin persiper apo ju caktohen ne mbledhje.

### **Neni 10**

#### **Sekretariati teknik**

Sekretariati teknik:

- a) ndihmon dhe mbeshtet Kryetarin e Komitetit ne organizimin dhe mbarevajtjen e mbledhjeve te Komitetit, duke kryer njoftimin e anetareve dhe dergimin e materialeve;
- b) Njofton anetaret e Komitetit, nepermjet kominukimit shkresor ose elektronik, jo me vone se 2 dite pune perpara, per daten dhe kohen kur do te zhvillohet takimi;
- c) Pergatit rendin e dites, pas miratimit nga Kryetari dhe njofton anetaret, jo me vone se 2 dite perpara mbledhjes dhe jo me vone se 1 dite ne rastin e rendit te rishikuar bazuar ne propozimet e anetareve;
- d) Pergatit te gjitha materialet dhe dokumentacionin e nevojshem per zhvillimin e mbledhjeve te Komitetit ( raporte, analiza, informacione, projekt-vendime, rekomandime etj), te cilat vihen ne dispozicion te te gjithe anetareve, jo me vone se 2 dite perpara dates se mbledhjes;
- e) Merr masat e duhura per mbajtjen e procesverbalit te mbledhjeve te Komitetit dhe jua dergon anetareve jo me vone se 2 dite pas perfundimit te mbledhjes;
- f) Kujdeset per shkembimin e informacioneve te nevojshme ndermjet anetareve te Komitetit;
- g) Kryen cdo detyre tjeter te caktuar nga Komiteti

### **Neni 11**

#### **Shpërblimi dhe pjesëmarrja e antarëve të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar**

- 1- Antarët e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, shpërblehen në masën 20.000 lekë për çdo mbledhje deri në 12 mbledhje vjetore. Pagesa kryhet nga ana e AAPSK në llogaritë e secilit anëtar brenda datës 10 të muajit në vazhdim.
- 2- Në rast mospranie të pajustificuar në mbledhje, anëtarit nuk i paguhet honorari respektiv për mbledhjen e rradhës.
- 3- Në rast mospranie të pajustificuar për më shumë se dy mbledhje rradhazi, Kryetari i Komitetit i drejtohet me shkresë Titullarit të Institucionit dërgues, me qëllim rikonsiderimin e një anëtari të ri.

### **Neni 12**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe ngarkohen të gjithë antarët dhe Sekretariati Tëeknik për zbatimin e saj.

**KRYETARI**

**ELENA PICI**